



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal Dragash

01 Nr.06-6355/1

Dt.28.04.2016

Dragash

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës-Dragash, pas trajtimit paraprak të Kërkesës së Degës së OVL të UÇK-së-Dragash për vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Dragash 01 Nr.353-5274, në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit të dt.28.04.2016, miratohet ky:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Kërkesa për vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Dragash.
- II. Platoja e vendosjes së shtatores është në qendër të Dragashit (ku aktualisht janë të vendosura selit e partive politike) dhe, njëherësh, sheshi pagëzohet me emrin e Komandantit Legjendar "Adem Jashari".
- III. Për implementimin e këtij Vendimi obligohen Kryesuesi i KK-së, Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Urbanizëm, Gjeodezi, Kataster dhe Mbrojtje të Mjedisit i Komunës Dragash.
- IV. Për veprimet e ndërmarra të njoftohet Kuvendi Komunal-Dragash.
- V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së dhe publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës-Dragash.

U dërgohet:

- Kryetarit të Komunës-Dragash z.Salim Jenuzi,
- MAPL-së (Zyrës Ligjore),
- Drejtoratit për Urbanizëm, Gjeodezi, Kataster dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash,
- Degës së OVL të UÇK-së Dragash, dhe
- Arkivit.

Kryesuesi i KK-së Dragash

Shaban Shabani

